

## Shtojca 11

### DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR SARANDE FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

20.08.2021

Drejtuar: *D E V I S sh.p.k me nr. NIPT K31420012M* me adrese Tirane Njësia Bashkiake Nr.8,  
Rruga Siri Kodra

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur, sherbime

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet e Drejtorisë Shërbimit Spitalor Sarandë ” me fond limit 97,256,679 ( nëntëdhjetë e shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, dhe nr. REF-97526-06-07-2021

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [14.06.2021] [92]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. D E V I S sh.p.k

NIPT K31420012M

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 96.880.898,80 leke pa tvsh

*(nëntëdhjetë e gjashtë milion e teteqind e tetëdhjetë mijë e nenteqind e nëntëdhjetë e tete presje tetëdhjetë )leke pa tvsh*

2. BOE LAVANTERI- ELITE NIPT L51511033S & NEW OPPORTUNITIES NIPT L71507037J

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 50,879.98leke pa tvsh

*(pesëdhjetë mijë e teteqind e shtatëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e tete) leke pa tvsh*

3. W.CENTER

NIPT K63029402A

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 0.00

*(zero) leke*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE LAVANTERI- ELITE NIPT L51511033S & NEW OPPORTUNITIES NIPT L71507037J

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 50,879.98leke pa tvsh

*(pesedhete mije e teteqind e shtatedhete e nente presje nentedhete e tete) leke pa tvsh*

Operatori ekonomik - BOE - " LAVANDERI ELITE " & " NEW OPPORTUNITIES " per proceduren e prokurimit ka paraqitur dokumentacion shkresor qe pas kontrollit te tij nga ana e KVO konstatohet se: 1. Ne kushtet e pergjitheshme te kualifikimit paragrafi 7 citohet: " Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur ", kete kusht BOE - " LAVANDERI ELITE " & " NEW OPPORTUNITIES " nuk e ploteson pasi deklarata ne fjale nuk eshte perpiluar nga cdo anetar i BOE por eshte paraqitur nje e vetme e nenshkruar nga perfaqesuesi i BOE.

2. Ne kriteret e veçanta pika a.- Formulari i ofertes sipas shtojces 1 nuk eshte i rregullt pasi nuk eshte paraqitur cmimi total i ofertes.

3. Ne kriteret e veçanta pika b - Deklarata per paraqitjen e ofertes se pavarur , sipas shtojces 1/1 nuk eshte e rregullt pasi nuk eshte zatur pika 6 germa b- nuk ka klikuar alternativën perkatëse.

4. Ne kriteret e veçanta pika ç - nuk ka paraqitur formularin e informacionit konfidencial sipas shtojces 4.

5. Ne kriteret e veçanta pika ë - BOE - Lavanderi Elite dhe New Opportunities, nuk e permbushin kete kriter pasi në SPE kanë ngarkuar vetëm një vërtetim të Lavanteri Elite për likuidimet e muajit Maj 2021. Në bazë të kontratës së nënshkruar me kompaninë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., afati i fundit i pageses është dita e fundit e muajit pasardhës.

Sa me siper BOE - Lavanderi Elite dhe New Opportunities, duhet te kishin paraqitur ne SPE vërtetim për shlyerje të të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë për muajin qershor 2021.

6. Nuk ploteson kriterin 3.2.1 - BOE - " Lavanderi Elite " dhe " New Opportunities " : ka paraqitur bilance për vitin 2018, 2019, 2020, te cilat jane vetëm nga Operatori ekonomik "Lavanderi Elite" shpk, operatori " New Opportunities " nuk ka paraqitur bilance.

7. Nuk ploteson kriterin 3.2.2 - Kontrata e bashkëpunimit nuk është e plotë, pasi i mungon aneksi 1, sipas përcaktimit tek neni 4 i saj - "Detyrimet e Paleve", pika 4.3 gërma "a" dhe gërma "b", ku thuhet që ndarja e shërbimeve dhe zërave do bëhet sipas "aneksit" nr 1. " Lavanderi Elite " merr persiper te realizoje 85 % të gjitha shërbimeve dhe zërave, kështu do ti duhej që dhe xhiron vjetore mesatare ta kishte 85 % të 40 % te fondit limit qe prokurohet, që i takon në vlerën 39,680,725 leke me tvsh.

Xhironja mesatare vjetore për " Lavanderi Elite " : Viti 2020 4,738,865 leke

Viti 2019 30,894,316 leke Viti 2018 5,439,410 leke Totali 3 viteve: 41,072,591 leke mesatarja e 3 viteve - 13,690,863.67 lek . 85 % e xhiros mesatare që ka " Lavanderi Elite" është 11,637,234 leke.

Pra edhe nëse do të ishte e plotë kontrata e bashkëpunimit ndërmjet "Lavanderi Elite" shpk dhe , Lavanderi Elite nuk e përmbush këte kriter. Kjo shoqëri duhet ta kishte mesataren e xhiros së tre viteve të fundit në vlerën 39,680,725 lekë me tvsh.

8. Per kriterin 3.2.3 - BOE - " Lavanderi Elite " dhe " New Opportunities " : ka paraqitur bilance për vitin 2018, 2019, 2020, te cilat jane vetëm nga Operatori ekonomik "Lavanderi Elite" shpk, operatori " New Opportunities " nuk ka paraqitur bilance financiare per tre vitet e fundit.

9. Per kriterin 3.3.1 - Kerkesat e ketij kriteri nuk plotësohet nga BOE - " Lavanderi Elite " dhe " New

Opportunities " pasi në SPE janë ngarkuar vetëm fatura tatimore shitjeje të shoqërisë "New Opportunities" shpk e cila në kontratën e bashkepunimit ka deklaruar që merr përsipër 15% të shërbimeve dhe zërave të punës.

" Lavanteri Elite" , qe merr persiper 85 % te volumit te sherbimit , nuk ka paraqitur asnje sherbim te ngjashem te realizuar gjate 3 viteve te fundit. Shoqeria " New Opportunities " ne Ekstraktin e Rregjistrimit Tregtar , ndermjet te tjerave , ka si objekt aktiviteti (... te beje blerjen e cdo lloj malli tekstili, ti shese ato, ti perpunoje ato, duke i ngjyrosur, hekurosur, qepur, larjen e tyre me kimikate dhe ngjyrosjen e tyre, ti importoje dhe eksportoje dhe ti prodhoje, te jape konsulence dhe trajnim per teknologjine e prodhimit te ketyre sherbimeve...). Pra ne SPE jane ngarkuar fatura tatimore larjeje me kimikate (ngjyrosje, qepje etiketa etj.) dhe jo sherbimi lavanterie dhe hotelerie.

10. Nuk ploteson kriterin 3.3.6 - Eshte paraqitur Akt Miratimi higjeno – sanitar vetem per " Lavanteri ELITE " kurse per op. ekonomik " New Opportunities" nuk ka paraqitur akt miratimi higjeno sanitar.

11. Per kriterin 3.3.7 - BOE - " Lavanderi Elite " dhe " New Opportunities " - ka paraqitur QKL per " Lavanteri ELITE " por nuk ka paraqitur per op. ekonomik " New Opportunities" .

12. Per kriterin 3.3.9 - BOE - " Lavanderi Elite " dhe " New Opportunities " ka paraqitur akt teknik per mbrojtjen nga zjarri vetem shoqeria " Lavanteri Elite " .

13. Per kriterin 3.3.10 - BOE - " Lavanderi Elite " dhe " New Opportunities " - Nuk e plotesojne kerkesat e ketij kriteri pasi nuk disponon personelin e kerkuar nga ana e AK sipas profesionit.

14.kriteri 3.3.11. kerkon qe Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë makineri për larje, tharje, hekurosje, paketimi, transporti dhe karroca shërbimi deri tek shtrati i pacientit, me kapacitet larjeje minimumi 193.46 kg në ditë, të vërtetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi dhe/ose kontrate qeraje për cdo makineri të vërtetuara me dokumenta (fatura blerje dhe/ose zhdoganimi që të vërtetojë pronësinë e qeradhënësit te cilat te paraqesin kodin perkates te makinerise). BOE - " Lavanderi Elite " dhe " New Opportunities " nuk i posedon te gjitha makinerite dhe pajisjet sipas kerkesave te AK.

15. Per kriterin 3.3.12 - Eshte lidhur nje kontrate furnizimi për detergjentët ndermjet nje person fizik dhe "Lavanteri Elite", e cila nuk eshte e vlefshme,pasi kjo kontratë ka një afat bashkëpunimi dy vjeçar dhe bazuar në Kodin Civil kontratat e tilla duhet të lidhen tek një zyrë noteriale.

2. W.CENTER

NIPT K63029402A

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera 0.00

(zero) leke

1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje document shkresor justifikues ne SPE.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë D E V I S sh.p.k me adrese Tirane Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga Siri Kodra, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 96.880.898,80 leke pa tvsh (nentedhjete e gjashte milion e teteqind e tetedhjete mije e nenteqind e nentedhjete e tete presje tetedhjete )leke pa tvsh/ totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, ‘Për Prokurimin Publik’.

**[Titullari i Autoritetit/entit Kontraktor]**

Arjan KALCUNI